




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
SHOQERIA "PRESTIGE BAILIFF SERVICES" SH.P.K



Adresa: Blv "Bajram Curri", Pall.6, perballë Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , Tel: (04) 2274847, e-mail: info@prestige.al



Tirane, me 16 // / 2017

Nr. 134 - 848 Prot.

URDHËR

Drejtuar : QENDRES KOMBETARE TE RREGJISTRIMIT

Adresa TIRANE

Per dijeni : Shoqeria "Zgjimi H.B" shpk

Per dijeni : Shoqeria "Rofix" shpk

Prane Zyres se Permbarimit Gjyqesor Privat te Shoqerise "Prestige Bailiff Services" sh.p.k. me kerkese te pales kreditore Shoqeria "Rofix" shpk eshte rregjistruar ceshtja permbarimore Nr.848 me pale:

**Kreditor: Shoqeria "Rofix" shpk me NIPT J81804007E me administrator znj. Aurora Gjinollari**

**Debitor : Shoqeria "Zgjimi H.B" shpk me NIPT L41723017J me administrator Hysen Selim Brati**

**Objekti : Kthim Shume**

**KONSTATOJ:**

Per titullin ekzekutiv fature tatimore shitje eshte leshuar Urdheri i ekzekutimit Nr. 7612 Akti date 01.12.2016 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane,

Në datë 16.01.2017 me vendim te Permbaruesit Gjyqesor Privat mbeshtetur dhe në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm titulli ekzekutiv dhe për rrjedhojë për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet vendosja e masës së bllokimit të dokumentacionit prane Qëndres Kombetare te Rregjistrimit (QKR) duke vendosur masen e sekuestros mbi aksionet e palës debitore Shoqeria "Zgjimi H.B" shpk me NIPT L41723017J me administrator Hysen Selim Brati , me qëllim mostjetërsimin e tyre.

**Për këte arsye :**

Në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile


**URDHËROJ**

-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne aksionet/quotat qe zoteron pala debitore Shoqeria "Zgjimi H.B" shpk me NIPT L41723017J me administrator Hysen Selim Brati

- 1.Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana e jonë.
- 2.Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
- 4.Ky urdhër mbahet ne 4 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor brënda 5 ditëve nga marrja dijeni.

PERMBARUES GJYQESOR


PETRI PIHONI







REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR



NR. 7612 AKTI

VENDIM  
LESHIM URDHERI EKZEKUTIMI

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane , e perbere nga :

**ANTONELA PRENDI –GJYQTARE**

asistuar nga sekretare gjyqesore **Dila Doçi**, sot me dt 01.12.2016, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore publike, ceshtjen civile me nr 7612 Akti, qe i perket:

**KERKUES** : Shoqeria “ Rofix” sh.p.k, me qender ne Durres, Nickel, Tapize, me administratore zj.Aurora Gjinollari, perfaqesuar nga av.Juxhin Shehaj sipas autorizimit nr 294/11 Prot,dt 30.11.2016.

**OBJEKTI** : Leshimi i urdherit te ekzekutimit per titujt ekzekutiv fatura tatimore te shitjes nr 2995, dt 14.11.2015, nr 2935, d 09.11.2015, nr 2797, dt 26.10.2015, nr 2642, dt 06.10.2015, nr 2588, dt 29.09.2015, nr 2363, dt 01.09.2015, nr 2211, dt 14.08.2015.

**BAZA LIGJORE** : Nenet 510/e, 511 te KPrC. Ligji nr 48/2014, dt 24.04.2014 “ Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregetare”.



UBLMK  
SHITJE  
SHITES

**Gjykata** pasi administroi provat, deklaroi te mbyllur hetimin gjyqesor, degjoi konkluzionet perfundimtare, ku kerkuesi kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit dhe si cmoi provat ne teresi

### VEREN

Shoqeria "Rofix" sh.p.k i eshte drejtuar gjykates me kerkesen objekt gjykimi per leshimin e urdherit te ekzekutimin per titujt ekzekutiv fatura tatimore shitje nr 2995, dt 14.11.2015, nr 2935, d 09.11.2015, nr 2797, dt 26.10.2015, nr 2642, dt 06.10.2015, nr 2588, dt 29.09.2015, nr 2363, dt 01.09.2015, nr 2211, dt 14.08.2015 ne baze te neneve 510/e, 511/c te KPrC dhe ligjit nr 48/2014, dt 24.04.2014 " Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregetare".

Nga hetimi gjyqesor i ceshtjes rezultoi e provuar se :

Shoqeria "Rofix" sh.p.k eshte person juridik qe ushtron veprimtari tregetare ne fushen e importit, eksportit dhe tregetimit te materialeve te ndertimit, hidrosanitare etj referuar te dhenave te ekstraktit te leshuar nga QKB.

Gjate ushtrimit te kesaj veprimtarie kerkuesi provohet te kete hyre ne marredhenie kontraktore me shoqerine "Zgjimi H.B" sh.p.k.


Objekti i kesaj marredhenie ka qene furnizimi i shoqerise "Zgjimi H.B" sh.p.k me materiale ndertimi nga kerkuesi shoqeria "Rofix" sh.p.k.

Sa me siper provohet nga faturat tatimore e shitjes nr 2995, dt 14.11.2015, nr 2935, d 09.11.2015, nr 2797, dt 26.10.2015, nr 2642, dt 06.10.2015, nr 2588, dt 29.09.2015, nr 2363, dt 01.09.2015, nr 2211, dt 14.08.2015 te leshuara nga shoqeria "Rofix" sh.p.k sipas te cilave rezulton ti jene shitur shoqerise "Zgjimi HB" sh.p.k materiale ndertimi ne sasite dhe vlerat respektive te percaktuara ne faturat tatimore.

Keto fatura jane leshuar sipas modelit te miratuar nga MF dhe jane nenshkruar rregullisht nga shitesi "Rofix" sh.p.k, bleresi "Zgjimi H.B" sh.p.k dhe transportuesi mallit.

Sipas pretendimeve te kerkuesit shoqeria "Zgjimi H.B" sh.p.k nuk ka paguar cmimin e mallit te blere sipas faturave tatimore te shitjes objekt gjykimi ndonese ka perfituar mallin e porositur dhe ka kaluar afati i pageses. Per kete shkak kerkohet leshimi i urdherit te ekzekutimit per faturat tatimore te shitjes te sipercituara me pretendimin se perbejne tituj ekzekutiv ne baze te nenit 16 te ligjit 48/2014 " Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregetare".



  
Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen objekt gjykimi ne raport me dispozitat procedurale mbi ekzekutimin e detyrueshem te titujve ekzekutiv cmon se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

Neni 510/1 i KPrC sanksionon :

*“ Ekzekutimi i detyrueshem mund te behet vetem ne baze te nje titulli ekzekutiv ”.* Ndersa ne paragrafin e dyte te kesaj dispozite parashikohet se *“ Jane tituj ekzekutiv : e) aktet e tjera qe sipas ligjeve te vecanta quhen tituj ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e permbarimit per ekzekutimin e tyre*

Gjykata cmon se ekzekutimit te detyrueshem i nenshtrohen vetem aktet qe sipas percaktimit ligjor te nenit 510 te KPrC cilesohen tituj ekzekutiv. Kete cilesi e gezojne jo vetem aktet qe ne menyre nominative jane percaktuar nga dispozita ne fjale, por edhe ato qe sipas ligjeve specifike konsiderohen tituj ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e permbarimit per ekzekutimin e detyrueshem te tyre. Pra pika e) e paragrafit te dyte te nenit 510 te KPrC eshte nje dispozite referuese qe zgjeron kuadrin e titujve ekzekutiv dhe me akte qe e marrin kete cilesim nga ligje specifike.

Neni 16 i ligjit nr 48/2014 “Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregetare “ sanksionon :

*“1. Detyrimet monetare te lindura nga veprimete juridike tregetare, te cilat nuk jane shlyer brenda afatit te pageses perkatese sipas ketij ligji, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne neinin 485 te KPrC, perbejne titull ekzekutiv dhe vihen ne ekzekutim nga permbaruesi gjyqesor pavaresisht vleres kur :*

*a)kreditore ka levruar mallrat apo kryer sherbimin sipas kontrates dhe ligjit dhe b)debitore nuk e ka permbushur detyrimin.*

*2. Ne kete rast detyrimi se bashku me kamatvonesat dhe me shperblimin per rikthimin e kredise mund te vihen ne ekzekutim te detyrueshem ne perputhje me parashikimet e Kodit te Procedures Civile “*

Referuar dispozites se mesiperme ligjore gjykata konkludon se faturat tatimore e shitjes te percaktuara ne objektin e kerkeses leshuar nga shoqeria “ Rofix“ sh.p.k per levrimin e mallrave shoqerise “ Zgjimi H.B “ sh.p.k plotesojne kriteret ligjore per tu cilesuar tituj ekzekutiv :

1.Vertetohet ekzistenca e **nje veprimi juridik tregetar** mes kerkuesit “ Rofix “ sh.p.k ( shitesi ) dhe shoqerise “ Zgjimi H.B “ sh.p.k ( bleresi) permes te cilit jane levruar mallra ( materiale ndertimi). Sipas nenit 3 te ligjit “ *Veprimi juridik*

tregetar eshte kontrata apo cdo veprim tjeter juridik i kryer ndermjet ndermarrjeve tregetare ose ndermjet ndermarrjeve tregetare nga njera ane dhe autoriteteve publike nga ana tjeter te cilat cojne ne levrimin e mallrave ose realizimin e sherbimeve kundrejt pageses ).

2. ndonese kerkuesi " Rofix " sh.p.k ka levruar mallrat sipas faturave tatimore te shitjes, bleresi " Zgjimi H.B " sh.p.k **nuk provohet te kete permbushur detyrimin monetar**, konkretisht pagesen e cmimit te mallit sipas faturave respektive. Sipas nenit 2 te ligjit : " Ky ligj zbatohet per te gjitha pagesat e kryera si kunderpagese per veprimet juridike tregetare "

Ne kushtet e mungeses se materializimit te marredhenies kontraktore mes paleve ne nje kontrate te shkruar dhe operimit ne treg permes kryerjes se furnizimeve mbi bazen e leshimit te faturave tatimore, afati i permbushjes se detyrimit monetar nga bleresi, ne mungese se nje afati te percaktuar nga palet konsiderohet ai i marrjes ne dorezim te mallit.

Detyrimi monetar qe buron nga faturat tatimore te shitjes nuk provohet te jete shlyer ne afat, pra pas marrjes ne dorezim te mallit nga bleresi.

3. sipas faturave tatimore te shitjes objekt gjykimi rezulton se shoqeria " Rofix " sh.p.k i ka levruar mallrat shoqerise " Zgjimi H.B " sh.p.k, e cila ne cilesine e debitorit **nuk provohet te kete kundershuar detyrimin.**

4. nuk provohet te ndodhemi ne kushtet e nenit 485 te KC.

5. nuk vertetohet ekzistenca e kushteve perjashtuese te zbatimit te ligjit sipas nenit 2 (te lidhura me natyren e detyrimit monetar) dhe nenit 15 ( koha e lindjes se detyrimit).

6. per ekzekutimin e titullit ekzekutiv me objekt detyrimet monetare sipas ligjit nr 48/2014 " Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregetare " ngarkohet zyra e permbarimit.

Ne perfundim gjykata cmon se faturat tatimore te identifikuara ne objektin e kerkeses perbejne tituj ekzekutiv sipas nenit 16 te ligjit nr 48/2014 " Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore tregetare " dhe nenit 510/e te KPrC. Ne keto kushte ne baze te nenit 510/c e KPrC gjykata vendos leshimin e urdherit te ekzekutimit per faturat tatimore te shitjes :

nr 2995, dt 14.11.2015- ne shumen 27 600 leke;

nr 2935, d 09.11.2015- 2 193 leke;

nr 2797, dt 26.10.2015- 236 408 leke;



nr 2642, dt 06.10.2015-27 300 leke;  
nr 2588, dt 29.09.2015 – 56 676 leke;  
nr 2363, dt 01.09.2015-54 600 leke;  
nr 2211, dt 14.08.2015- 128 218 leke

leshuar nga shoqeria “ Rofix “ sh.p.k per mallrat e levruara shoqerise “Zgjimi H.B“ sh.p.k.

### PER KETO ARSYE

Ne baze te neneve 510/e, 511/c te KPrC, gjykata

### VENDOSI

- 1.Pranimin e kerkeses.
  - 2.Leshimin e urdherit te ekzekutimit per faturat tatimore te shitjes nr 2995, dt 14.11.2015, nr 2935, d 09.11.2015, nr 2797, dt 26.10.2015, nr 2642, dt 06.10.2015, nr 2588, dt 29.09.2015, nr 2363, dt 01.09.2015, nr 2211, dt 14.08.2015 leshuar nga shoqeria “ Rofix “ sh.p.k per shoqerine “ Zgjimi H. “ sh.p.k.
  - 3.Ky urdher hartohet ne nje kopje.
  - 4.Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkuesit.
  - 5.Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
- U shpall sot me 01.12.2016 Tirane**


**SEKRETARE**

**DILA DOCI**



**GJYOTARE**

**ANTONELA PRENDI**



### SHPENZIMET GJYQESORE

Taksa gjyqesore 200 leke  
Shpenzime fletethirrje 100 lek



Handwritten scribbles or marks in the top right corner.

Handwritten text, possibly a signature or date, located at the bottom center of the page.